



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË  
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL  
PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË  
MËSUESVE TËSHKOLLAVE ME DREJTIM TË ORIENTUAR  
ARTISTIK**

**DEGA “ART FIGURATIV, MUZIKË, KOREOGRAFI -BALET”**

**SHKURT, 2023**

**Koordinatorë**

## TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE.....	3
II. QËLLIMI I PROGRAMIT .....	3
III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT .....	4
3.1 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të tretë të kualifikimit.....	5
3.1.1 <i>Fushat kryesore të zhvillimit profesional</i> .....	5
3.1.2 <i>Modele të testeve për nivelin arsimor të shkollave me drejtim të orientur artistik, AML</i> 15	
3.2 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit 40	
3.2.1 <i>Model planifikimi i specialitetit për nivelin arsimor të shkollave me drejtim të orientur artistik, AML</i> .....	41
3.2.2 <i>Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur</i> .....	48

## I. HYRJE

Mësuesi është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Një mësuesi, për të qenë i aftë në punën e tij, nuk i duhet të zotërojë vetëm lëndën, por edhe të dijë ta transmetojë atë sa më lehtësisht te nxënësit, nëpërmjet metodologjive bashkëkohore. Mësuesit punojnë me përgjegjshmëri dhe integritet, kanë njohuri të forta përmbajtësore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, zhvillojnë dhe përditësojnë njohuritë nëpërmjet vlerësimeve dhe vetëvlerësimeve të vazhdueshme, ndërtojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe bashkëpunojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të të gjithë mësuesve të shkollave me drejtim të orientuar artistik degët: *art figurativ, muzikë dhe koreografi –balet* është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të shkollave me drejtim të orientuar artistik në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë të kualifikimit, si dhe për përgatitjen e orës së hapur mësimore për marrjen e kategorisë së parë të kualifikimit,
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen.

## II. SYNIMET DHE QËLLIMET E PROGRAMIT

Synimet e hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi janë:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të shkollave me drejtim të orientuar artistik, në degët përkatëse: art figurativ, muzikë dhe koreografi, në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DRAP-et, ZVAP-të, përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrojë një program të detyruar dhe të unifikuar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

### ***Programi ka për qëllim që mësuesi:***

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë risitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet globale që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin, çështjet e barazisë gjinore etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënies - nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar; të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

### **III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

**Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në dy pjesë:**

3.1 *Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë (Mësues specialist) dhe të tretë (Mësues i kualifikuar) të kualifikimit. Në këtë rubrikë përfshihen, përveç kompetencave profesionale dhe rezultateve të pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, edhe dy modele testesh për ndihmë të gjithë mësuesve të shkollave me drejtim të orientuar artistik, në degët përkatëse: art figurativ, muzikë dhe koreografi, në arsimin parauniversitar, në nivelin arsimor: *arsim i mesëm i lartë (AML)* të shkollave me drejtim të orientuar artistik.*

3.2 *Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë (Mësues mjeshtër) të kualifikimit. Në këtë rubrikë ka dy modele orësh mësimore për ndihmë të gjithë mësuesve të shkollave me drejtim të orientuar artistik, në degët përkatëse: art figurativ, muzikë dhe koreografi, në arsimin parauniversitar, në nivelin arsimor: *arsim i mesëm i lartë (AML)* të shkollave me drejtim të orientuar artistik si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur në degët përkatëse: art figurativ, muzikë dhe koreografi.*

### ***3.1 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të tretë të kualifikimit***

Programi për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë të kualifikimit përmban fushat kryesore të zhvillimit profesional, si dhe modele testesh për ndihmë të gjithë mësuesve të shkollave me drejtim të orientuar artistik, në degët përkatëse: art figurativ, muzikë dhe koreografi, në AML.

#### **3.1.1 Fushat kryesore të zhvillimit profesional**

Ky program është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve të kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë janë:

- dokumentacioni zyrtar<sup>1</sup> shkollor, i cili ka të bëjë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve në shkollë;
- programe lëndore të specialitetit/lëndës;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënie – nxënie të specialitetit/lëndës;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;

<sup>1</sup>Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-itqë zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve të specialitetit/lëndës.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

<b>FUSHA “DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR”</b>	
<b>Kompetenca</b> <b>“Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të</b> <b>legjislacionit dhe dokumentacionit</b> <b>shkollor”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i shkollave të mesme me drejtim të orientuar artistik::</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe Rregulloren për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës;</li> <li>• demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies-nxënies;</li> <li>• zbaton etikën profesionale të mësuesit;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</li> <li>• Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020</li> <li>• Udhëzimi nr.22 “Për fillimin e vitit shkollor 2022-2023 në sistemin arsimor parauniversitar”, MAS (27.07 2022).</li> <li>• Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar me Udhëzimin nr.14, date 28.7.2021</li> <li>• Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li> <li>• respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>• zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.</li> </ul>	<p>procedurat e kualifikimit të mësuesve”.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> <li>• Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> </ul>
---	--

## FUSHA “PROGRAME LËNDORE TË TRI DEGËVE

### KOREOGRAFI, ART FIGURATIV DHE MUZIKË”

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p><b>“Zbatimi në mënyrë efektive i kurrikulës në arsimin me drejtim të orientuar artistik”</b></p>	
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i shkollave të mesme me drejtim të orientuar artistik::</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton programin e kurrikulës në <i>degën</i> dhe <i>specialitetin</i> përkatës dhe si zbatohet ajo në shkollë;</li> <li>• përshtat programin lëndor në përputhje me ecurinë teknike të nxënësit sipas klasave;</li> <li>• përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit;</li> <li>• gjen ose harton materiale plotësuese artistike që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program;</li> <li>• gjen ose harton materiale plotësuese artistike që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre ndaj artit;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza Kurrikulare 2014.</li> <li>• Kurrikula e shkollave artistike, miratuar nga MASR-ja, Tiranë, 2017.</li> <li>• Qëllimet e arsimit me drejtim të orientuar artistik, (sipas degës).</li> <li>• Programet e përgjithshme të lëndëve: <i>teorike-artistike</i>.</li> <li>• Programet e lëndëve: <i>praktike-artistike</i>.</li> <li>• Programet e lëndës së <i>specialitetit</i>.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• harton rezultate të nxëni për lëndën/specialitetin, për tema mësimore ose grup temash, në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e programit dhe nivelit të nxënësit;</li> <li>• kategorizon rezultatet e të nxënit e programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit;</li> <li>• tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve në <i>degën</i> dhe <i>specialitetin</i> përkatës);</li> <li>• përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit në <i>degën</i> dhe <i>specialitetin</i> përkatës;</li> <li>• siguron informacion që demonstroi lidhjen e <i>specialitetit</i> përkatës me shkencat e tjera dhe me jetën reale.</li> </ul>	
--	--

**FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”**

<b>Kompetenca I</b>  <b>“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien në arsimin me drejtim të orientuar artistik”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësuesi i shkollave të mesme me drejtim të orientuar artistik:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;</li> <li>• përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve;</li> <li>• demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015.</li> <li>• Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit të shkollave me drejtim të orientuar artistik me nxënësit e tij.</li> </ul>



<ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstroi qëndrim pozitiv ndaj <i>artëve</i> dhe <i>specialitetit</i> që përfaqëson/drejton;</li> <li>• identifikon nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar);</li> <li>• identifikon nxënësit me prirje të veçanta jo vetëm në zhanrin klasik por edhe në zhanre të tjera;</li> <li>• planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta;</li> <li>• demonstroi qëndrim pozitiv ndaj <i>artëve</i> dhe <i>specialitetit</i>;</li> <li>• edukon të nxënësit dashurinë dhe kërkshërinë ndaj lëndës/specialitetit;</li> <li>• motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre;</li> <li>• krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>• punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.</li> </ul>	
<p><b>Kompetenca II</b></p> <p><b>“Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e <i>specialitetit/lëndës</i> në arsimin me drejtim të orientuar artistik”</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i shkollave të mesme me drejtim të orientuar artistik:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar në degën ku ai zhvillon specialitetin/lëndën;</li> <li>• përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve;</li> <li>• planifikon orën mësimore, bazuar mbi metodë artistike specifike të specialitetit;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimit mesëm), IZHA (sot ASCAP) 2016.</li> <li>• Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> <li>• Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP 2020, shkolla të mesme me drejtim të orientuar artistik.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve;</li> <li>• përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;</li> <li>• përdor proceset artistike në mësimdhënien – nxënien e muzikës;</li> <li>• demonstroi teknika/forma të ndryshme për vlerësimin e nxënësit;</li> <li>• shpjegon parimet e hartimit të një detyre përmbledhëse (lëndët teorike) dhe parimet e ngritjes së komisioneve vlerësuese si: kontroll teknik/ saxho .</li> </ul>	
<p><b>Kompetenca III</b></p> <p><b>“Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies, në arsimin me drejtim të orientuar artistik”</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i shkollave të mesme me drejtim të orientuar artistik:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• prezanton materialet apo dokumentet e veta lidhur me lëndët teorike/praktike artistike, duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Finale, Design, Type në Word etj.;</li> <li>• nxiti nxënësit të bëjnë prezantime në lëndët artistike duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta;</li> <li>• gjen dhe përdor materiale nga Website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien;</li> <li>• përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndëve të ndryshme artistike apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga website.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit që përdoren në klasat VI - IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X - XII të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie - nxënie.</li> <li>• Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021.</li> <li>• Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021.</li> </ul>

### FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”

Kompetenca	Literatura
<b>“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”</b>	
<b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësuesi i shkollave të mesme me drejtim të orientuar artistik:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;</li> <li>• sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.</li> <li>• Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020</li> <li>• Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”</li> </ul>

### FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”

Kompetenca	Literatura
<b>“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”</b>	
<b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësuesi i shkollave të mesme me drejtim të orientuar artistik:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njeh rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe;</li> <li>• demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.</li> </ul>

### FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<b>“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien dega muzikë”</b>	

<p><i>Mësuesi i shkollave të mesme me drejtim të orientuar artistik::</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>dallon konceptet dhe shprehitë kryesore me të cilat operon lënda e muzikës në klasat VI-IX dhe X-XII;</li> <li>përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve muzikore në klasat VI-IX dhe X-XII;</li> <li>përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehive;</li> <li>dallon ndërvarësinë e koncepteve muzikore nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera;</li> <li>zhvillon me kreativitet mënyra të ndryshme të zhvillimit të veprimtarive artistike të cilat përdorin konceptet dhe aftësitë e programeve VI-IX dhe X-XII;</li> <li>mbledh informacion të saktë e bindës për nxënësit e tij rreth vlerave përdoruese të muzikës me artet e tjera dhe me shkencat e tjera dhe në jetën e përditshme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Programe dhe tekste të lëndës së muzikës për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X-XII për arsimin e mesëm të lartë.</li> </ul>
--	--

### FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

<p><b>Kompetenca</b></p> <p><b>Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien dega Art Pamor</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><i>Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik dega “Art pamor”:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>demonstron njohuri të qëndrueshme dhe të sakta shkencërisht në artin pamor;</li> <li>shpjegon elementet dhe parimet, duke i evidentuar ato në vepra të ndryshme arti;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Teksti “Arti i Rilindjes dhe i Pavarësisë në Shqipëri”, me autor Ferid Hudhri.</li> <li>Teksti “ Historia e artit” Gombrich, që përdoret në Akademinë e Arteve.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• shpjegon proceset e realizimit artistik në artin pamor;</li> <li>• shpjegon saktë vlerat e artit botëror dhe përfaqësuesit e tyre; <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>arti prehistorik, arti në Mesopotami, arti egjiptian, arti egje, arti grek, arti romak, kristianizmi i hershëm, arti bizantin, përfaqësuesit dhe veprat e tyre,</i></li> <li>- <i>arti islamik, arti kinez, qytetërimet e hershme në Amerikë,</i></li> <li>- <i>arti në mesjetë, mesjeta e hershme, artiromanik, arti gotik,</i></li> <li>- <i>arti në rilindje, gotiku i vonë, rilindja e parë, rilindja e lartë, manjerizmi, baroku, rokoko,</i></li> <li>- <i>neoklasicizmi, romantizmi, realizmi, impresionizmi, postimpresionizmi, avangardat artistike, arti në shekullin XX;</i></li> </ul> </li> <li>• shpjegon saktë vlerat e artit shqiptar dhe përfaqësuesit e tyre; <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>arti shqiptar (kultura ilire),arti grek i kolonive (Butrinti, Apolonia, Dyrrahu) mozaikët e lashtë në Shqipëri,</i></li> <li>- <i>Onufri, arti në Shqipëri- ikonografët e shekullit XVIII,</i></li> <li>- <i>arti në Shqipëri- periudha e rilindjes dhe periudha e pavarësisë, realizmi socialist në Shqipëri.</i></li> </ul> </li> </ul>	
---	--

<b>FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS</b>	
<b>Kompetenca</b>	
<b>Respektimi i rigorozitetit shkencor në</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>

mësimdhënien dega Koreografi - balet	
<p><i>Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik, dega “Koreografi”:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstroi njohuri të qëndrueshme dhe të sakta shkencërisht në artin koreografik;</li> <li>• shpjegon elementet dhe parimet e artit koreografik, duke i evidentuar ato në vepra të ndryshme koreografike;</li> <li>• shpjegon proceset e realizimit artistik në një kërcim;</li> <li>• shpjegon saktë vlerat e artit të kërcimit botëror dhe përfaqësuesit e tyre:</li> </ul> <p><i>Baleti në Evropë gjatë shek. XVII – XVIII:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillimi i mëtejshëm i kërcimit,</li> <li>- shkollat dhe koreografët italianë dhe francezë,</li> <li>- tiparet kryesore.</li> </ul> <p><i>Epoka e Noverit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Reformat e Zhan Zhak Noveri,</li> <li>- baletet kryesore të Nover.</li> </ul> <p><i>Romantizmi dhe tiparet e tij në kërcim:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- botëkuptimi romantik,</li> <li>- baleti i parë romantik,</li> <li>- koreografët, kërcimtarët dhe kompozitorët më të njohur të romantizmit.</li> </ul> <p><i>Baleti Rus në shek. 20 dhe baletet e para simfonike:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zhvillimi i baletit rus,</li> <li>- “Rilindja” e kërcimit klasik,</li> <li>- Marius Petipa dhe P.I.Çajkovski,</li> <li>- Anterpriza e S.Djagilievit.</li> </ul> <p><i>Kërcimi klasik në shek. 20 dhe format kryesore të tij:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kërcimi Klasik në Evropë,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Historia e Artit Koreografikshqiptar-Dedin Suli, 2010.</li> <li>• Historia e Baletit Botëror, Skënder Selimi.</li> <li>• Baleti në Shqipëri / Skënder Selimi, 1992.</li> <li>• Folklori Koreografik Shqiptar, Skënder Selimi, 2003.</li> <li>• Metodika e kërcimit klasik, Shpëtim Dajçi.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- kërcimi Klasik në Amerikë,</li> <li>- format e baletëve,</li> <li>- përfaqësuesit më të njohur.</li> </ul> <p><i>Lindja e kërcimit modern dhe përfaqësuesit e tij:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- lindja e kërcimit modern në Amerikë,</li> <li>- zhvillimi i tij në Evropën Perëndimore,</li> <li>- shkollat kryesore,</li> <li>- përfaqësuesit.</li> </ul> <p><i>Baleti në Shqipëri:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- lindja e baletit në Shqipëri,</li> <li>- pedagogët dhe kërcimtarët e parë,</li> <li>- krijimi i shkollës dhe trupës profesionale,</li> <li>- baletet shqiptare.</li> </ul>	
---	--

**Modele të testeve për nivelin arsimor AML (të shkollave me drejtim të orientuar artistik)**

**Profili: 1) ART PAMOR**

**DOKUMENTACIONI SHKOLLOR**

1. Proces-verbalet e komisioneve dhe çdo material i konkursit në arsimin e orientuar ruhen në arkivin e shkollës për: **1 pikë**
  - A) 1 vit
  - B) 2 vjet
  - C) 6 muaj
  - D) 3 muaj
  
2. Kur një nxënës fitues **NUK** paraqitet në shkollë brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga fillimi i vitit shkollor, nxënësi tjetër, sipas radhës në listë, gëzon të drejtën e pranimit në shkollë. **1 pikë**
  - A) 5 ditëve
  - B) 10 ditëve.
  - C) 15 ditëve.
  - D) 20 ditëve.
  
3. Listoni dy synime të shprehura në programin orientues të kualifikimit të mësuesve të arsimit të orientuar: **2 pikë**

a) \_\_\_\_\_

### **DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR**

1. Drejtuesi i rrjetit të zhvillimit të vazhduar profesional mund të drejtojë dhe të organizojë veprimtarinë e rrjetit për një periudhë: **1 pikë**

- A) 4 vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje.
- B) 4 vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.
- C) 2 vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje.
- D) 2 vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Bazuar në standardet e formimit të përgjithshëm të mësuesit në arsimin parauniversitar, një mësues analizoi të gjithë treguesit e standardit “Njohja dhe zbatimi i dokumentacionit arsimor”. Nga vetëvlerësimi i treguesve të këtij standardi, i rezultoi që mesatarja e pikëve për këtë standard ishte 2,9. Përcaktoni nivelin e arritjes së këtij standardi që korrespondon me këtë mesatare të pikëve: **1 pikë**

- A) Niveli 1
- B) Niveli 2
- C) Niveli 3
- D) Niveli 4

3. Përcaktoni dy ndër format e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë: **2 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_

### **PROGRAMI LËNDOR**

4. **Rrethoni përgjigjen e saktë.**

Përfundimi i arsimit në degën e Artit figurativ, përveç mundësisë për vazhdimin e arsimit në nivelin e mëtejshëm universitar, u jep mundësi nxënësve t’i drejtohen tregut të punës si: **1 pikë**

- A) Ndhimës kostumograf në teatër ose televizion
- B) Si grafik i mesëm në një studio grafike
- C) Butaforist në teatrin e kukullave
- D) Të tria si më sipër

5. Plotësoni vendet bosh në fjalinë e mëposhtme. **2 pikë**

*Kohëzgjatja e arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik, dega “Art figurativ është:*



\_\_\_\_\_ për nxënësit që vijnë nga shkollat \_\_\_\_\_ të përgjithshme.

6. Renditni *tri (3) grupet* e lëndëve që përbëjnë kurrikulën e arsimit me drejtim të orientuar artistik, në degën “Art pamor”. **3 pikë**

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

### ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË

7. Rrethoni përgjigjen e saktë. **1 pikë**

Njëra nga pohimet e mëposhtme është një strategji mësimore efektive. Ajo përdoret për të zhvilluar aftësinë e nxënësve në shpjegimin e hapave, që ata ndjekin gjatë procesit të realizimit të punimeve artistike.

- A) Nëpërmjet drejtimit periodik të pyetjeve, që nxënësit në mënyrë vullnetare të shprehin mendimin e tyre personal mbi punimin dhe ecurinë e punës.
- B) Nxënësit shkruajnë në letër mbi çdo punë të përfunduar duke bërë një përshkrim llogjik mbi punën e tyre
- C) Ngrija e nxënësve në mënyrë të rastësishme, në fillim të çdo ore mësimore, për të diskutuar progresin e punës së tyre dhe qëllimet.
- D) Zyrtarizimi i seancave të rregullta kritike, gjatë së cilës të gjithë nxënësit përgjigjen pyetjeve për punën e tyre.

8. Elementi kyç për arritjen e suksesit gjatë një procesi të nxëni, është: **1 pikë**

- A) Motivimi i nxënësve. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.
- B) Integrimi i teorisë me praktikën e specialitetit për të cilën ata mësojnë.
- C) Përdorimi i metodave të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm aftësitë praktike por edhe njohuritë teorike dhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi.
- D) Të gjitha më lartë.

9. Plotësoni vendet bosh në fjalinë e mëposhtme. **2 pikë**

Në arritjen e suksesit të nxënësve në specialitetin e tyre ndihmon *integrimi i* \_\_\_\_\_ *me* \_\_\_\_\_.

10. “Njeh zhvillimin dhe përdorimin e perspektivës, përgjatë periudhave të ndryshme kohore të historisë së artit”, është një nga rezultatet e pritshme në fund të klasës së 10-të në lëndën e perspektivës.

Renditni deri në tre strategji mësimore efektive për realizimin e saj.

3 pikë

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

c) \_\_\_\_\_

11. Jepni shpjegimin e termit “Metodë mësimore”.

2 pikë

Metoda mësimore është/ janë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

12. Jepni shpjegimin për formulimet e mëposhtme.

4 pikë

a) Rëndësia e mjedisit të të nxënës në zhvillimin e lëndëve artistike dhe kriteret që duhet të plotësohen do të thotë:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

b) Rëndësia e mjeteve didaktike në zhvillimin e lëndëve artistike do të thotë:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

## ASPEKTE TË KOMUNIKIMIT DHE ETIKËS

12. Në një klasë ku ka nxënës me aftësi të ndryshme të të nxënës, mësuesi:

1 pikë

- A) vendos rezultate të ndryshme të nxënës.
- B) punon me të gjitha nivelet e nxënësve.
- C) fokusohet te nxënësit me nivel më të ulët.
- D) fokusohet te nxënësit me nivel të lartë.

14. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) për qëllimet e Kodit të etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar: **2 pikë**

a) Të ndihmojë mësuesin dhe punonjësit e tjerë të arsimit për të njohur, për të kuptuar dhe për të zbatuar standardet etike të nevojshme për realizimin e misionit të arsimit dhe për të marrë vendime në kuadrin e realizimit të këtij misioni. V/G \_\_\_\_

b) Të vendosë standarde të ndryshme etike në fushën e arsimit në nivel kombëtar. V/G \_\_\_\_

### ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

15. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë? **1 pikë**

- A) viti 11-të i shkollës
- B) viti i 11 i shkollës
- C) viti i 11-t i shkollës
- D) viti i 11-të i shkollës

16. Përcaktoni nëse janë shkruar saktë (S) ose gabim (G), shprehjet e mëposhtme. **3 pikë**

- a) livadhe të gjelbër \_\_\_\_
- b) atlas gjeografik \_\_\_\_
- c) Instituti i Shëndetit Publik \_\_\_\_

### PËRMBATJA SHKENCORE E LËNDËS

Rrethoni përgjigjen e saktë.

13. Marcel Duchamp pak para Luftës së Parë Botërore realizoi veprën e tij të parë të rëndësishme: **1 pikë**

- A) Nudo duke zbritur nga shkallët(1912)
- B) Burimi (1917)
- C) Rrotë biçiklete (1913)
- D) Prelud për një krah të thyer (1915)

14. *Format artistike* që patën ndikim të impresionizmi ishin: **1 pikë**

- A) Arti folklorik dhe fotografia
- B) Arti japonez dhe fotografia
- C) Fotografia dhe arti akademik
- D) Arti kinez dhe arti japonez

15. Ndryshimi midis *fotografisë tradicionale* dhe asaj *dixhitale*, është se fotografia dixhitale i lejon artistit: **1 pikë**

- A) Riprerjen e imazhit të fotografuar për të krijuar një kompozim të ri
- B) Realizon një numër të pakufizuar fotografish pa qenë nevoja të karikohet
- C) Regullon kontrastin dhe ngjyrën në imazhe të veçanta
- D) Mund të shohë imazhet përpara se të printohen

16. Karakteristika dalluese e *stilit bauhaus* është:

1 pikë

- A) Thekson vlerën individuale të objekteve të realizuara me dorë
- B) Plasticitetin e materialeve të reja e modelon në dizajnin tradicional
- C) I fton konsumatorët të gjejnë përdorime të reja për dizajnin standard
- D) Integron funksionin, teknologjinë dhe estetikën e dizajnit

17. Karakteristikë kryesore e *vizatimit xhestual* është:

1 pikë

- A) Konturi
- B) Aksioni dhe lëvizja
- C) Gradacionet e dritëhijes
- D) Detajet e pasqyruara me kujdes

18. *Termi* që përshkruan më mirë një *vepër arti*, e cila përfshin *elemente të teatrit*, siç janë lëvizjet e trupit, spektatorët, muzikën dhe imazhe të projektuara është:

1 pikë

- A) Mimesis
- B) Instalacion artistik
- C) Performanca artistike
- D) Kolazh dixhital

19. *Teknika* që Leonardo da Vinci zhvilloi në mënyrë sistematike, për të krijuar thellësinë në pejzazh, pasi studioi në mënyrë shkencore qiellin ishte:

1 pikë

- A) Perspektivën me një pikë
- B) Perspektivën me dy pika
- C) Perspektivën me tre pika
- D) Perspektivën ajrore

20. *Teknika e afreskut* ka të bëjë me:

1 pikë

- A) Pikturimin mbi suvanë ende të freskët
- B) Pikturimin mbi suvanë e thatë e të lëmuar
- C) Përdorimin e ngjyrave të tretura në dyllë ose në recinë
- D) Vendosjen e bojërave të zbutura mbi suvanë e thatë nëpërmjet spatulës

21. *Nëinterioret e periudhës Rokoko* shprehet unitet midis:

1 pikë

- A) Dyerve dhe dritareve

- B) Hapësirës arkitektonike, arredimit dhe dekoracioneve
- C) Dritës dhe errësirës
- D) Ngjyrës dhe arredimit

22. *Grafiti urban* (grafitet e mureve) është një formë arti: **1 pikë**

- A) Ku artistët përdorin bojrat e vajit
- B) Ku dominon figuracioni
- C) Që shpreh ideologjinë borgjeze
- D) Shpesh provokativ

23. Njëri nga artistët e mëposhtëm nuk është Venecian: **1 pikë**

- A) Bramante
- B) Veroneze
- C) Ticiani
- D) Xhorxhone

24. Vendosni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) për shprehjet e mëposhtme. **3 pikë**

\_\_\_\_\_ Hapësirë është zona midis dhe përreth objekteve. Hapësira përreth objekteve shpesh quhet hapësirë pozitive.

\_\_\_\_\_ Vetëm ngjyrat parësore janë ngjyra të pastra. Të gjitha të tjerat derivojnë nga përzierja e ngjyrave të para.

\_\_\_\_\_ Ngjyrat e treta krijohen nga përzierja e një ngjyre të parë me një ngjyrë të dytë. Shembuj të ngjyrave të treta janë: blu, blu në jeshile, blu në lejla.

25. Plotësoni vendet bosh në fjalitë e mëposhtme. **2 pikë**

Në mesin e shek. V- të p.e.s., skulptori grek, i cili shkruajti një traktat të quajtur "*kanoni*" ku përcaktonte se: "*Bukuria e trupit qëndron te proporcionet e të gjitha pjesëve me njëra-tjetrën.*"

- a) Shkruani emrin e skulptorit që shkruajti "*kanonin*".

\_\_\_\_\_

- b) Gjeni veprën e artit që reflekton më së miri idenë e tij.

\_\_\_\_\_

26. Shpjegoni ndryshimin midis *formave artistike* të zhvilluara *nëperiudhën e neolitit* nga *format artistiketë paleolitit*, duke i parë ato tek: **4 pikë**

1) Banesat:

---


---

2) Në pikturat e shpellave:

---

---

27. Duke iu referuar pikturës egjiptiane, ku paraqitja e imazhit bëhej në një mënyrë të kodifikuar gjeni: **2 pikë**



a) Si vendosen figurat e personazheve në pikturën egjiptiane?

---

---

---

b) Si paraqitet figura e njeriut?

---

---

---

28. Kubizmi përgjatë rrugëtimit të tij shpesh ndahet nga studiuesit në *tre periudha specifike*. Ato janë: **3 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

c) \_\_\_\_\_

29. Përmendni *dy piktorët* më të njohur të periudhës Gotike në Itali:

**2 pikë**

---

---

30. Nisur nga vepra e mëposhtme e piktorit Pol Kle, jepni përgjigjet e duhura.

**3 pikë**



a) Kujt periudhe i përket vepra “Figura të kuqe” e Pol Kle?

---

---

b) Përshkruani si janë përdorur elementet e artit në vepër.

---

---

---

31. Kontrasti koloristik në veprën “Pallati i Dukës” e Klod Monet është shembull i: **1 pikë**



Kontrastit \_\_\_\_\_

*Klod Monet (Claude Monet), “Pallati i Dukës” Venecia, 1908, vaj në kanavacë*

32. Vepra e mëposhtme e Pikasos i përket periudhës artistike të quajtur “Periudha blu”. Përshkruani karakteristikat e veprës duke u nisur nga psikologjia e ngjyrës. **2 pikë**



---

---

---

---

*Pablo Pikaso, “Vakti i njeriut të verbër”, 1903*

33. Renditni dy karakteristika kryesore të pikturës së *Karavaxhos*. **2 pikë**

---

---

34. Shpjegoni kërkesat e mëposhtme. **2 pikë**

a) Funkcionin e harkut të triumfit në qytetërimin romak

---

---

b) Përshkruani një prej tyre në Romë

---

---

**35.** Koleksioni i kodikëve përbën një prej pasurive kulturore të popullit shqiptar. Duke ditur rëndësinë e tyre shpjegoni:

**3 pikë**

a) Çfarë janë kodikët?

---

---

b) Cila është rëndësia e tyre?

---

c) Përmendni emrin e kodikut më të rëndësishëm në koleksionin e Arkivit Qendror të Shtetit.

---

**Modele të testeve për nivelin arsimor AML (të shkollave me drejtim të orientuar artistik)**

**Profili: 2) MUZIKË**

**DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR**



1. Drejtuesi i rrjetit të zhvillimit të vazhduar profesional mund të drejtojë dhe të organizojë veprimtarinë e rrjetit për një periudhë: **1 pikë**

- A) vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje.
- B) vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.
- C) 2 vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje.
- D) 2 vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Bazuar në standardet e formimit të përgjithshëm të mësuesit në arsimin parauniversitar, një mësues analizoi të gjithë treguesit e standardit “Njohja dhe zbatimi i dokumentacionit arsimor”. Nga vetëvlerësimi i treguesve të këtij standardi, i rezultoi që mesatarja e pikëve për këtë standard ishte 2,9. Përcaktoni nivelin e arritjes së këtij standardi që korrespondon me këtë mesatare të pikëve: **1 pikë**

- A) Niveli 1
- B) Niveli 2
- C) Niveli 3
- D) Niveli 4

3. Përcaktoni dy ndër format e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë: **2 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_

## PROGRAMI LËNDOR

4. Cila nga alternativat e mëposhtme **NUK** ka të bëjë me zhvillimin e *kompetencave profesionale artistike* të nxënësit në përfundim të arsimimit në degën Muzikë. **1 pikë**

- A) Përdorin burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve artistike, të nevojshme për zhvillimin e tyre personal dhe artistik;
- B) Nxisin potencialin e tyre të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente në fushën e artit dhe të muzikës;
- C) Angazhohen fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin artistik, personal dhe shoqëror;
- D) Zhvillojnë ekspedita kërkimore mbi artin nëpër zona.

5. Njohuritë në lëndën e harmonisë zhvillojnë te nxënësit aftësi të ndryshme praktiko - artistike. Jepni tri prej tyre. **3 pikë**

- \_\_\_\_\_.
- \_\_\_\_\_.
- \_\_\_\_\_.

6.Renditni dy materiale apo mjete didaktike që duhet të përdorë mësuesi gjatë një ore mësimi për të pasuruar programin e lëndës: (përcaktoni saktë lëndën së cilës i referoheni) **2 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_

## ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË

7.Mësuesii *specialitetit* gjatë procesit mësimor duhet të zotërojë dhe zbatojë:  
**1 pikë**

- A) praktika orientuese që zbatohen në mënyrë të diferencuar
- B) metoda të bazuara në kritere të sakta shkencore pedagogjike
- C) metoda që zbatohet sipas klisheve të mësuesit
- D) metoda unike dhe të zbatueshme për të gjithë

8.Aftësitë artistike të nxënësve janë të ndryshme, ndaj për mësuesin e specialitetit *metoda e mësimdhënies* duhet të jetë: **1 pikë**

- A) me karakter krijues
- B) me rregulla strikte zbatimi
- C) empirike
- D) Asnjërën nga të trija

9.Renditni tre arsye pse mësuesi duhet të trasmetojë tek nxënësit e tij dashuri për specialitetin?**3pikë**

- a) \_\_\_\_\_.
- b) \_\_\_\_\_.
- c) \_\_\_\_\_.

10.Me *mësimdhënie bashkëkohore*, do të kuptojmë:  
**2 pikë**

- a) \_\_\_\_\_.
- b) \_\_\_\_\_.

11.Çdo fund viti shkollor, nxënësit prezantojnë veprat e mësuara para një komisioni, detyrim i cili shërben: **3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_.

- b) \_\_\_\_\_.
- c) \_\_\_\_\_.

**12.** Për formimin e nxënësit si instrumentist/këngëtar është dhe përballja me publikun në koncerte. Kjo gjë kërkon që mësuesi të: **3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_.
- b) \_\_\_\_\_.
- c) \_\_\_\_\_.

### ASPEKTE TË KOMUNIKIMIT DHE ETIKËS

**13.** Në një klasë ku ka nxënës me aftësi të ndryshme të të nxënësve, mësuesi: **1 pikë**

- A) vendos rezultate të ndryshme të nxënësve.
- B) punon me të gjitha nivelet e nxënësve.
- C) fokusohet te nxënësit me nivel më të ulët.
- D) fokusohet te nxënësit me nivel të lartë.

**14.** Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) për qëllimet e Kodit të etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar: **2 pikë**

- a) Të ndihmojë mësuesin dhe punonjësit e tjerë të arsimit për të njohur, për të kuptuar dhe për të zbatuar standardet etike të nevojshme për realizimin e misionit të arsimit dhe për të marrë vendime në kuadrin e realizimit të këtij misioni. V/G \_\_\_\_
- b) Të vendosë standarde të ndryshme etike në fushën e arsimit në nivel kombëtar. V/G \_\_\_\_

### ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

**15.** Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë? **1 pikë**

- A) viti 11-të i shkollës
- B) viti i 11 i shkollës
- C) viti i 11-t i shkollës
- D) viti i 11-të i shkollës

**16.** Përcaktoni nëse janë shkruar saktë (S) ose gabim (G), shprehjet e mëposhtme. **3 pikë**

- a) livadhe të gjelbër \_\_\_\_
- b) atllas gjeografik \_\_\_\_

c) Instituti i Shëndetit Publik \_\_\_\_

## PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

### Rrethoni përgjigjen e saktë

17. Tingëllim i njëjtë me tonalitetin *Sol b Maxhor* është tonaliteti: **1 pikë**
- A) Fa maxhor
  - B) Fa # minor
  - C) Fa # maxhor
  - D) Fa maxhor harmonik
18. Instrumenti i perkusionit pa *lartësi tingulli* është: **1 pikë**
- A) cajon
  - B) snare drum
  - C) timpani
  - D) cimbali
19. Artet me ndërmjetësi muzikore i përkasin periudhës së: **1 pikë**
- A) Mesjetës
  - B) Antikitetit
  - C) Rilindjes
  - D) Barokut
20. Gjatë periudhës Barok, interesi i ringjallur për dramën greke kontribuoi në zhvillimin e formave të mëposhtme muzikore si: **1 pikë**
- A) Oratorio
  - B) Villanella
  - C) Opera
  - D) Singspiel
21. Elemente muzikore popullore të Lindjes përfshihen në krijimet e kompozitorit: **1 pikë**
- A) Alban Berg
  - B) Samuel Barber
  - C) Béla Bartók
  - D) Pierre Boulez
22. Periudha në të cilën filloi të vendosej emri i kompozitorit në vepër ishte: **1 pikë**

- A) Mesjeta
- B) Rilindja
- C) Antikiteti
- D) Baroku

23. Arkanxhelo Koreli:

1 pikë

- A) është një kompozitor i njohur për përpunimin e stilit klasik të violinës, por nuk arriti të vlerësohej siç duhet nga bashkëkohësit e vet.
- B) punoi për një kohë të gjatë nëpër kisha dhe institucione fetare dhe si rrjedhojë, shkroi vetëm muzikë kishtare.
- C) kundërshtoi hapur prirjet e reja në muzikë dhe në gjithë veprat e tij i qëndroi besnik traditës së deriatëhershme.
- D) si kompozitor bëri që vepra për violinë të fitonte ekuilibrin e formës, të pasurohej nga ana teknike dhe të bëhej më e qartë.

24. Reformatori i operas *seria* Kristof Vilibald Gluk çoi më tej parimet e:

1 pikë

- A) Klaudio Monteverdit
- B) Zhan Batist Lyli
- C) Henri Persell
- D) Reinhard Kajzeri

25. *Cikli simfonik* me katër kohë u përcaktua nga:

1 pikë

- A) Moxart
- B) Hajden
- C) Bethoven
- D) List

26. Me termin *kadencë ritmike* kuptojmë:

1 pikë

- A) shenjën e rënies fundore të një vepre
- B) lojën e lirë virtuoze dhe të improvizuar të instrumentistit
- C) bashkimin e pikpamjeve muzikore apo zanore me atë letrare dhe gojore
- D) asnjërën nga të trija

27. Cili prej pohimeve *nuk* është i saktë:

1 pikë

- A) Në shekullin XVIII lindja operas “*bufa*” dhe “*seria*” erdhi si rrjedhim i gjendjes së re shoqërore politike që ishte krijuar në Evropë.

- B) Në shekullin XVIII nga opera kërkohet trajtimi dhe pasqyrimi me vërtetësi i ngjarjeve të jetës së përditshme.
- C) Në shekullin XVIII kërkohet që në opera të pasqyrohet heroikja tragjike dhe dramati e jetës.
- D) Në shekullin XVIII kërkohet që në opera të pasqyrohetin tiparet kombëtare

**28. Shkruani kuptimin e termave muzikorë: 2 pikë**

tonalitet muzikor

\_\_\_\_\_

Tingujenharmonik \_\_\_\_\_

**29. Renditni deri në 3 kuptime të ndryshme të përdorimit të termit “muzikë klasike” 3 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

c) \_\_\_\_\_

**30. Shpjegoni shkurtimisht se çfarë karakteristikash kanë pjesët përbërëse të periudhës në muzikë: 3 pikë**

a) Motivi \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

b) Fraza

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

c) Fjalia

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**31. Plotësoni: 4 pikë**

Rastet kur tinguj a rrokje që përplasen në vesh në mënyrë të pakëndshme quhet \_\_\_\_\_

Kur lëvizja e tingujve bëhet në ngritje dhe në zbritje nga ½ toni quhet \_\_\_\_\_

Kalimi i theksit të fortë në kohë të butë quhet \_\_\_\_\_

Raporti i caktuar i tingujve të theksuar dhe të patheksuar quhet \_\_\_\_\_

32. Renditni deri në 3 forma muzikore të ansamblit të dhomës.

4 pikë

---

---

---

---

33. Në vizat para çdo fjalie shkruani shkronjën V nëse pohimi është i vërtetë dhe shkronjën G nëse pohimi është i gabuar: **4 pikë**

\_\_\_\_\_ Instrumentet në periudhën e Barokut renditen sipas një *rendi kohor* organo-klavicembalo-violina.

\_\_\_\_\_ Muzika instrumentale në periudhën e Rilindjes u përdor për shoqërimin e dramës liturgjike.

\_\_\_\_\_ *Koncertet Branderburgeze* bëjnë pjesë në muzikën për klavicembalo.

\_\_\_\_\_ Lidhja e drejtpërdrejtë e muzikës me kulturën popullore kombëtare ishte karakteristike e periudhës së Romantizmit.

34. Përcaktoni në fragmentet e mëposhtme muzikore tipet e ndërtimeve muzikore si *monodi*, *homofoni*, *polifoni*: **3 pikë**

A. \_\_\_\_\_

B. \_\_\_\_\_

C. \_\_\_\_\_

D. \_\_\_\_\_

E. \_\_\_\_\_

F. \_\_\_\_\_

35. Renditni deri në dy përfaqësues të kulturës muzikore franceze në gjysmën e dytë të shek XIX: **2 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_

36. Nga sonata nr.11 Moxart shpjegoni:

**4 pikë**

- karakteristikat e krijimtarisë së autorit
- formën muzikore (skematizoje)
- karakterin
- analizë harmonike



Andante grazioso

Wolfgang Amadeus Mozart

© 2000 by Steiner & Sons Corporation. All rights reserved.

## Modele të testeve për nivelin arsimor AML (të shkollave me drejtim të orientuar artistik)

### Profili: 3) BALET

#### DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR

1. Drejtuesi i rrjetit të zhvillimit të vazhduar profesional mund të drejtojë dhe të organizojë veprimtarinë e rrjetit për një periudhë: **1 pikë**

- A) 4 vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje.
- B) 4 vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.
- C) 2 vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje.
- D) 2 vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Bazuar në standardet e formimit të përgjithshëm të mësuesit në arsimin parauniversitar, një mësues analizoi të gjithë treguesit e standardit “Njohja dhe zbatimi i dokumentacionit arsimor”. Nga vetëvlerësimi i treguesve të këtij standardi, i rezultoi që mesatarja e pikëve për këtë standard ishte 2,9. Përcaktoni nivelin e arritjes së këtij standardi që korrespondon me këtë mesatare të pikëve: **1 pikë**

- A) Niveli 1
- B) Niveli 2
- C) Niveli 3
- D) Niveli 4

3. Përcaktoni dy ndër format e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë: **2 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_

#### PROGRAMI LËNDOR

4. Vlerësimi i nxënësve në një orë mësimi bëhet sipas: **1 pikë**

- A) Mësimnxënies në klasë;
- B) Arritjeve individuale;
- C) Rezultateve të lëndës;
- D) Modeleve të krijuara më parë.

5. Programi i historisë së kërcimit botëror trajton në mënyrë të hollësishme: **3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_

c) \_\_\_\_\_

6.Gjatë planifikimit të një ore mësimore kërcimi, mësuesi duhet të mbështetet: **2 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

### ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË

7.Metoda Vaganova është një pikë referimi për mësuesit e baletit klasik sepse: **1 pikë**

- A) bazohet mbi virtuoizmin;
- B) konsideron emocionin si pjesën më të rëndësishme të lëvizjes;
- C) është e njohur në vende të ndryshme;
- D) analizon në mënyrë të detajuar të gjithë elementet teknik të traditës akademike.

8.Gjatë procesit mësimor mësuesi u jep nxënësve mundësi të: **1 pikë**

- A) promovojnë punën në grup;
- B) eksplorojnë trupin dhe të njohin vetveten;
- C) aftësohen teknikisht dhe artistikisht;
- D) alternativat e mësipërme janë pjesë e pandarë e procesit.

9.Termi “*Metodologji*” në kërcim perkufizohet: **3 pikë**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

10.Plotësoni vendet bosh në fjalitë e mëposhtme. **2 pikë**

*Baleti kontemporan në procesin mësimor ka specifikat e tij ku:*

- a) Lëvizjet zhvillohen në tokë dhe në \_\_\_\_\_, dhe
- b) me ritme dhe \_\_\_\_\_ të ndryshme.

11.Çdo fund viti akademik, nxënësit dhe mësuesit prezantojnë punën e tyre para një komisioni. Kjo gjë shërben: **3 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

c) \_\_\_\_\_

12. Baleti klasik, kontemporan dhe vallja popullore kanë kodet dhe kufizimet e tyre teknike.

Jepni disa prej tyre.

**3 pikë**

- a) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

### ASPEKTE TË KOMUNIKIMIT DHE ETIKËS

13. Në një klasë ku ka nxënës me aftësi të ndryshme të të nxënësve, mësuesi:

**1 pikë**

- A) vendos rezultate të ndryshme të nxënësve.  
B) punon me të gjitha nivelet e nxënësve.  
C) fokusohet te nxënësit me nivel më të ulët.  
D) fokusohet te nxënësit me nivel të lartë.

14. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) për qëllimet e Kodit të etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar: **2 pikë**

- a) Të ndihmojë mësuesin dhe punonjësit e tjerë të arsimit për të njohur, për të kuptuar dhe për të zbatuar standardet etike të nevojshme për realizimin e misionit të arsimit dhe për të marrë vendime në kuadrin e realizimit të këtij misioni. V/G \_\_\_\_
- b) Të vendosë standarde të ndryshme etike në fushën e arsimit në nivel kombëtar. V/G \_\_\_\_

### ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

15. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

**1 pikë**

- A) viti 11-të i shkollës  
B) viti i 11 i shkollës  
C) viti i 11-t i shkollës  
D) viti i 11-të i shkollës

14. Përcaktoni nëse janë shkruar saktë (S) ose gabim (G), shprehjet e mëposhtme. **3 pikë**

- a) livadhe të gjelbër \_\_\_\_  
b) atlas gjeografik \_\_\_\_  
c) Instituti i Shëndetit Publik \_\_\_\_

## ASPEKTE SHKENCORE TË LËNDËS

### Rrethoni përgjigjen e saktë

17. Shkolla e kërcimit të Operas së Parisit u themelua në 1713 nga: **1 pikë**

- A) Luigi XIV
- B) Cari i Rusisë
- C) Marius Petipa
- D) Jean-Baptiste Colbert

18. Kompozitori i baletit “Rajmonda” është: **1 pikë**

- A) Ricardo Drigo
- B) Alexander Glazunov
- C) Ludwig Minkus
- D) Franz List

19. Cili nga emrat e mëposhtëm **nuk** i përket baletit klasik **1 pikë**

- A) Rudolf Nureyev
- B) Jose Perez
- C) Jose Limon
- D) Massimo Murru

20. Baleti që i përket periudhës së romantizmit të vonë, por që ka formë klasike dhe me përmbajtje romantike është: **1 pikë**

- A) Liqeni i Mjelmave
- B) Bukuroshja e fjetur
- C) Zhizel
- D) Zogu i zjarrtë

21. Baleti neoklasik u kristalizua në mesin e viteve 20 në: **1 pikë**

- A) Amerikë
- B) Itali
- C) Rusi
- D) Angli

22. *Developpe* është një nga lëvizjet bazë të: **1 pikë**

- A) Battment fondy
- B) Grand Battment

- C) Adagio
- D) Asnjëra prej tyre

23. *Attitude*, si lëvizje është frymëzuar nga një skulpturë antike:

1 pikë

- A) Apollo e Dafne të Lorenzo Berninut
- B) Merkuri fluturues i Jean de Boulogne
- C) Davidi i Michelangelos
- D) Venus i Milos

24. Termi i mëposhtëm duhet të shkruhet: 1 pikë

- A) Sison
- B) Sissonne
- C) Sisone
- D) Asnjëra nga të tria

25. Ritmet muzikore më të përdorura gjatë orës së baletit klasik janë:

1 pikë

- A) 2/4, 3/4, 6/8
- B) 2/4, 3/4, 5/8
- C) 2/4, 3/4, 7/8
- D) 3/4, 5/8, 7/8

26. Termi "*Croisse*" do të thotë:

1 pikë

- A) Linjë e kryqëzuar me publikun
- B) Linjë e drejtë me publikun
- C) Linjë në profil me publikun
- D) Linja të duarve

27. Nuk ekziston nga këto "*entrechat*":

1 pikë

- A) *Entrechat-cinque*
- B) *Entrechat-trois*
- C) *Entrechat-deux*
- D) *Entrechat-quatre*

28. "Vdekja e mjelmës" është një nga pjesët më të njohura të repertorit klasik botëror. 2 pikë

- a) Emri i kompozitorit \_\_\_\_\_
- b) Emri i veprës ku bën pjesë \_\_\_\_\_

29. Plotësoni fjalinë e mëposhtme:

3 pikë

*New York City Ballet* është kompania e krijuar nga koreografi \_\_\_\_\_  
me origjinë \_\_\_\_\_, i cili është edhe themelues i stilit \_\_\_\_\_ në Amerikë.

**30.** Shpjegoni lëvizjen "*Attitude derriere*": **2 pikë**

- a. \_\_\_\_\_  
b. \_\_\_\_\_

**31.** Jepni shpjegimin nga ndryshon termi "*Assemble*" i shkollësitaliane nga ajo e shkollës ruse: **2 pikë**

- a. \_\_\_\_\_  
b. \_\_\_\_\_

**32.** Jepni shpjegimin e termit "*sissonne*" në baletin klasik: **2 pikë**

- a. Bën pjesë në grupin e \_\_\_\_\_  
b. Të biesh \_\_\_\_\_

**33.** Vendosni përkrah secilit balet, emrin e kompozitorit. **3 pikë**

- a) Baleti "Romeo e Zhuljeta" \_\_\_\_\_  
b) Baleti "Princi Igor" \_\_\_\_\_  
c) Baleti "Zogu i Zjarrtë" \_\_\_\_\_

**34.** Jepni saktë përkufizimet e mëposhtme. **2 pikë**

Kërcimi është \_\_\_\_\_ .

Baleti është \_\_\_\_\_ .

**35.** Plotësoni fjalinë e mëposhtme: **2 pikë**

*Pina Bausch* krijoi gjininë e \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ .

**36.** Gjeni a) nëse termat "*En Cloche*" dhe "*Balancoire*" janë sinonimike, dhe b) teknikës që i përkasin? **2 pikë**

- a. \_\_\_\_\_  
b. \_\_\_\_\_

37. Plotësoni fjalinë e mëposhtme:

2 pikë

Puantet janë përdorur për herë të parë në vitet \_\_\_\_\_. Balerina e parë që kërcëu mbi to është\_\_\_\_\_ .

38. *Jean-George Noverre* njihet si reformator në balet. Listoni deri në dy prej reformave të tij.

2 pikë

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

39. Jepni shpjegimin e termit "*pirouettes*", dhe llojet e "*pirouettes*".

2 pikë

---

---

---

40. Renditni strukturën klasike të "*Pas de deux*" sipas 5 (Pesë) pjesëve të ndara.

3 pikë

---

---

---

---

---

### ***3.2 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parëkualifikimit***

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, përse i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënësve dhe përshtaten me stilet e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirëmenaduar dhe e mirëplanifikuar, si dhe një mjedis të nxënësve efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësve. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të



siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Programi orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit përmban model ore mësimore për AML-në si dhe kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur.

### 3.2.1 Model ore mësimore për nivelin AML

Për të orientuar mësuesit që do të zhvillojnë orën mësimore të hapur për kategorinë e parë të kualifikimit, më poshtë është dhënë një model ore mësimore për secilin nivel arsimor: AML. *Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënësve, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.* Lëndë teorike artistike për shkollat artistike do të jenë të njëjta me lëndët e kulturës së përgjithshme me ndonjë specifikë konkrete.

<b>Fusha:</b> Arte	<b>Lënda:</b> Histori Baletit Botëror	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> XI
<b>Tematika</b> Baleti europianë gjysmën e dytë të shekullit të XIX			
<b>Tema mësimore</b> Charl Didlo në formimin e teatrit të baletit rus.		<b>Situata e të nxënësve</b> Reflektim mbi rëndësinë dhe funksionin e kërcimit	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas sipas temës</b> <b>Nxënësi/ja :</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njeh zhvillimin e baletit europian post romantik;</li> <li>- Evidenton periudhën e parë të Didlos në St.Petersburg</li> <li>- Shpjegon ndryshimet që pësoi baleti në rusi në shekullin e XIX;</li> <li>- Emërton koreografët,baletet , kompozitorët dhe balerinët e shek. XIX ;</li> <li>- Vlerëson rolin e zhvillimin e teknikës në shkollën ruse;</li> <li>- Shpjegon rritjen e rritjen e baletit simfonik dhe mënyrën e ndërtimit të këtyre baleteve.</li> </ul>		<b>Fjalë kyç</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Charles-Louis Didelot,</li> <li>- Shën Petersburg,</li> <li>- Flora and Zephyr,</li> <li>- Apollo et Daphne.</li> </ul>	
<b>Burimet</b> Leksione të përgatitura Pamje dhe video të baleteve.		<b>Lidhja me lëndët e tjera</b> Danc historik Mjeshtri kërcimi	
<b>Organizimi i orës së mësimin</b> <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme</b> <b>( Stuhi mendimi ) (5-7 minuta)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësuesi pyet nxënësit rreth njohurive të tyre për baletin në periudhën e romantizmit:</li> <li>- Cili ishte baleti që shënon fillimin e periudhës romantike?</li> </ul>			

- Cili ishte baleti që shënoi pikën kulminante të priudhës romantike?
- Cilat ishin figurat kryesore të periudhës romantike?
- Kush ishin risitë e që solli kjo periudhë në teknikën e kërcimit klasik si dhe karakteristikat e baletit romantik?

Dëgjimi i veprës “*Flora and Zephyr* “ |

<https://www.youtube.com/watch?v=BpeIUsx2PHM>

### **Ndërtimi i njohurive të reja**

Mësuesi shkruan në tabelë:

- 1767- Charles Louis Didelot ka lindur në January 1767 Stockholm.
- 1786 to 1801-Charles studioi me babain e tij për 15 vjet.
- 1795- këpucët e para të baletit u krijuan nga Charles Didelot.
- 1799- Charles u quajt, "King of Ballet", ne Suedi.
- 1801- Charles Didelot u emërua Koreografi i Imperial Ballet Theater ne Rusi.
- Ai është koreografi i parë që ngriti balerinën në puante (via his "flying machine") - in 1815 në balletin *Flora and Zephyr* (1815),nuk u kërcye në puante por ishte ngritja e parë në majë të gishtave.
- 1809-Charles Didelot dëmtoi këmbën e tij në një aksident dhe nga ky moment ai nuk kërcëu me.

### **Punë në grupe**

*Leximi i leksionit*

Mësuesi u kërkon nxënësve të lexojnë leksionin dhe të nënvizojnë informacionin e paqartë për ta.Mësuesi ndan nxënësit në grupe dhe i shpërndan materialinAi sqaron termat, konceptet dhe informacionin.

Pas përfundimit të punës një përfaqësues për çdo grup prezanton materialin dhe punën e bërë mbi të.

### **Punë në çifte**

Mësuesi i ndan detyrat për çdo çift dhe i kërkon që për një pjesë të caktuar njëri të hartojë pyetje ndërsa tjetri të gjejë përgjigjet.

Nxënësit i drejtojnë pyetjet njëri – tjetrit duke respektuar edhe përgjigjet.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

Mësuesi fton nxënësit t’u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

- Përse është quajtur babai i baletit në rusi Charl Loui Didelo?
- Në sa periudha ndahet qëndrimi i tij në rusi?
- Ku u përqëndrua Charles-Louis Didelot gjatë qëndrimit të parë në rusi?
- Cilat ishin risitë që solli në shkollën e baletit rus?
- Si ishin të ndërtuara klasat e baletit?
- Kush ishte baleti i parë dhe kush ishte kompozitori i saj?
- Cili ishte kuptimi i termit *danse d’école*?
- Ku u mbështet Didelo gjatë periudhës së dytë për krijimin e veprave të tij?
- Kush janë veprat kryesore gjatë kësaj periudhe ?
- Cila ishte merita e këtij koreografi?

### Vlerësimi

Gjatë zhvillimit të këtyre temave, vlerësimi kërkon të masë aftësitë e nxënësit. nxënësi vlerësohet për demonstrimin e aftëve në:

**Niveli 2:** Përcaktimin e periudhës së parë të *Charloui Didelo* në St Petersburg.


**Niveli 3:** Shpjegimin e periudhës së parë të *Charloui Didelo* në St Petersburg, duke argumentuar rëndësinë e koreografisë së tij.

**Niveli 4:** Analizimin e zhvillimit të teknikës në shkollën ruse.

**Detyrat dhe puna e Charles-Louis Didelot babai i baletit në Rusipavarur**

Ese me temë : “”.

### Model ore mësimore në Specialitetin: “Mjeshtri kërcimi”, dega: Balet.

<b>Dega:</b> Koreografi -balet	<b>Lënda:</b> Mjeshtri e Kërcimit Klasik	<b>Shkalla:</b> VI	<b>Klasa:</b> XII
<b>Tematika:</b> Ushtrimet në puante			
<b>Tema mësimore</b> Grand fouette en tournant en dedans dhe en dehors me mbarim ne efface dhe croise.		<b>Situata e të nxënit</b> Reflektim mbi rëndësinë dhe funksionin e kërcimit.	
<b>Kohëzgjatja:</b> 10 orë			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas sipas temës</b> <b>Nxënësi/ja</b> <b>Në fund të kësaj teme është në gjendje të:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Njihet me terminologjinë e koncepteve <i>croise dhe efface</i>.</li><li>- Shpjegojë konceptet <i>en dehors dhe endedans</i>.</li><li>- Zbatojë rolin e shoqërimit muzikor.</li><li>- Vlerësojë rëndësinë e battement në 90° duke mos anashkaluar pikat.</li></ul>		<b>Fjalë kyç</b> Fouetteen tournant, attitude, en dedans, en dehors, ecarte, retire, passe, balance.	
<b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Leksione të përgatitura,</li><li>- Pamje dhe video të variacioneve të ndryshme. <a href="https://www.youtube.com/watch?v=CgKXn1Evj-o">https://www.youtube.com/watch?v=CgKXn1Evj-o</a> <a href="https://www.youtube.com/watch?v=w3UTAf3-Big">https://www.youtube.com/watch?v=w3UTAf3-Big</a></li></ul>		<b>Lidhja me fushat/lëndët e tjera</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Repertor Skenik</li><li>- Duet Klasik</li></ul>	
<b>Fazat e realizimit të ushtrimit</b> Mësuesi i jep përgjigje pyetjeve rreth njohurive për <i>fouetten</i> : <ul style="list-style-type: none"><li>- Cfarë është një grand fouette në balet?</li><li>- Si mësohet një fouette ?</li><li>- Kush është balerina që ekzekutoi për herë të parë 32 fouette ?</li><li>- Kush balet përmban 32 fouette?</li><li>- A janë të vështira fouettet në puante?</li><li>- Si mund ti përmirësojmë fouettet në puante?</li></ul>			

- Sa fouette duhet të bëhen gjithsej?

### **Ndërtimi i njohurive të reja**

Mësuesi shpjegon ushtrimin nga ana teorike dhe praktike.

### **Zbërthimi i ushtrimit**

*Ushtrimi iparë:*

- Në momentin që bëjmë Grand fouette ndalojmë në pozicionin e parë.
- Hedhim këmbën anash, por në momentin që po e bëjmë ushtrimin, nuk duhet të peshojmë, por duhet të rrëshqasim në pozicionin e parë.
- **Kur** bëjmë fouetenë nxënësi duhet të kthehet duke i dhënë përparësi këmbës së mbështetjes.
- Këmbe e punës hidhet lart.
- Ky ushtrim ekzekutohet në puante në këmbën mbështetëse ndërsa këmba e punës bën një rond de jambe.
- I jepet përparësi këmbës së mbështetjes.

### **Punë në grupe**

- Mësuesi i ndan nxënësit në grupe dhe kërkon që të evidentohen elementët përbërës të materialit.
- Pas përfundimit të punës një përfaqësues për çdo grup prezanton materialin dhe punën e bërë mbi të.

### **Punë në sallë të baletit**

- Releveja duhet të jetë e shpejtë.
- Duhet të mbajmë ritmin i cili është poshtë, lart.
- Duart duhet të kalojnë në mënyrë organike.
- Fokusimi në pikat e ka shumë rëndësi.
- Nuk duhet të thyhemi në mes gjatë uljes kur mblidhemi në pirouette.
- Mësuesi u kërkon nxënësve ta përsërisin.
- Nxënësit punojnë në grup dhe në mënyrë individuale.
- Nxënësit dialogojnë me njëri tjetrin rreth pikave të ndërmjetme të ushtrimit (detaji)
- Nxënësit motivojnë njëri-tjetrin gjatë realizimit të më shumë fouetteve.

### **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

- Nuk duhet të merrni frymë nga barku por duhet të mbyllni brinjët.
- Është e rëndësishme të mbani trupin tuaj drejt, lart e poshtë në çdo kthesë,
- Rrotulloni bacinin duke e mbajtur atë drejt.
- Mos i hapni krahët më shumë se çduhet .
- Mos i zgjasni krahët në shpinë duke i lëkundur ato pas bustit sa herë që përkuleni sepse të tërheq për pas.
- Përdorni vizionin tuaj periferik .
- Edhe kur hapim krahët në pozicionin e dytë , krahët dhe këmba e punës duhet të qëndrojnë pak para jush.
- Mendon për të tërhequr shpejt krahun tuaj anësor , pasi do t'ia sjell trupin tuaj me më shumë forcë dhe do të lehtësojnë këmbën tuaj yë mbështetjes.
- Punoni me balancën e trupit.
- Një nga celësat për fouette perfekte është ekuilibri i shkëlqyer , e cila arrihet vetëm përmes praktikës.

- Ngrihuni në një rënë këmbë duke u fokusuar në mbajtjen e ekuilibrit .(Ushtrime për të forcuar pulpën)
- Bëmi pilates sepse forcon qëndrën tuaj e cila është thelbësore për rrotullimet.
- Balerina e nis fuetten duke shtyrë në këmbën e mbështetjes për të gjeneruar double turns.
- Por pjesa e vështirë është ruajtja e rrotullimit.

### Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit kryhet sipas përmbushjes së niveleve të arritjeve për:

#### Niveli 2

- Njohjen e terminologjisë së lëvizjeve *croise* dhe *efface*; *en dehors* dhe *endedans*; *battemant* në 90°.

#### Niveli 3

- Zbatimin konceptet *croise* dhe *efface*.
- Shpjegimin konceptet *en dehors* dhe *endedans*.


#### Niveli 4

- Ekzekutimin *croise* dhe *efface*.
- Ekzekutimin *en dehors* dhe *endedans*.
- Ekzekutimin *battemant* në 90° duke mos anashkaluar pikat.
- Respektimin e rolit të shoqërimit muzikor gjatë lëvizjeve *croise* dhe *efface*; *en dehors* dhe *endedans*.

### Detyrat dhe puna e pavarur

Praktikë individuale për realizimin e 32 *fouetteve*.

## Model ore mësimore në Specialitetin “Grafikë”, dega Art figurativ.

PLANIFIKIMI PËR DETYRËN 1			
Dega: Art figurativ	Lënda: Grafikë	Klasa: X	Shkalla V
Tema mësimore/Detyra 1: Organizimi i hapësirës			
Kohëzgjatja e detyrës: 32 orë ( 4 orë në javë )			
Rezultatet arritjes për detyrën:			
Në fund të kësaj detyre nxënësi/ja duhet të jetë në gjendje:			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillojë aftësitë për punimin e kompozicionit sipërfaqësor me anën e vijave të detyrës;</li> <li>• zbatojë teknikën apo elementet duke paraqitur variantin tonal të kompozicionit sipërfaqësor;</li> <li>• krijojë duke organizuar variante të ndryshme koloristike të kompozicionit në detyrë.</li> </ul>			
Fazat për realizimin e detyrës 1			
1.1. Grumbullimi i materialeve. (letër, laps, rapid, element nga natyra:si gjethe të formave të ndryshme, lule etj)			
1.2. Thjeshtëzimi dhe stilizimi. (Bashkimi në kompozim i elementëve të marrë nga natyra të interpretohen pa detaje duke i parë si			

volume grafike.)

1.3. Kompozimi dhe lëvizja në kuadrat. (Në një sipërfaqe të madhe nëpërmjet një katrori të hapur, zgjedhim sipërfaqen më interesante)

## METODOLOGJIA E NDJEKUR

### Njohja me konceptet bazë përmes tutorialeve

[https://www.youtube.com/watch?v=BDePyEFT1gQ&list=PLiOil1qP-cMURN\\_8baOr3QWfySmIjqKIj](https://www.youtube.com/watch?v=BDePyEFT1gQ&list=PLiOil1qP-cMURN_8baOr3QWfySmIjqKIj)

[https://www.youtube.com/watch?v=U11B\\_0FCn6o&list=PLiOil1qP-cMURN\\_8baOr3QWfySmIjqKIj&index=7](https://www.youtube.com/watch?v=U11B_0FCn6o&list=PLiOil1qP-cMURN_8baOr3QWfySmIjqKIj&index=7)



Përdorimi i teknologjisë për të komunikuar në një mënyrë të drejtpërdrejtë me nxënësit lidhur me detyrën. ndiqen tutorialet për të krijuar idenë mbi konceptet bazë të organizimit të kompozimit përmes linjave dhe hapësirës.

### Bashkëvepruese.

Nxënësit bashkëpunojnë duke ndarë reagime dhe reflektime njëri-tjetrit ndaj detyrës që do realizojnë. Të punosh në mënyrë bashkëpunuese do të thotë që pjesë e procesit të të mësuarit është krijimi i një hapësire të sigurt për gabime dhe madje edhe dështime.

### Gjithëpërfshirëse.

Detyra artistike krijon mundësi të një mjedisi gjithëpërfshirës pasi duhen marrë parasysh aftësitë, nevojat dhe intersat e të gjithë nxënësve.

Mësuesi siguron që nxënësit respektohen, por përfshihen në mënyrë aktive në mjedisin e klasës.

### Puna individuale.

Nxënësit zhvillojnë të menduarit në mënyrë krijuese, e cila u vjen natyrshëm në lidhje me detyrën.

Vetëbesimi artistik i bën ata të lirë dhe kreativ, për të realizuar artin e tyre në stilin e tyre.

## VLERËSIMI

**N2 – nota 5-6**

Nxënësi/ja është i nivelit MJAFTUESHËM kur demonstroi aftësitë për të zhvilluar punimin e kompozicionit sipërfaqësor me anën e vijave të detyrës.

Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur:

- kompozon me defekte strukturore;
- ushtron pak koncepte bazë të zberthimit grafik;
- përshkruan konceptin grafik në mënyrë të përciptë;
- kupton me vështirësi ndryshimin midis mënyrës së ndërtimit të kontrastit në vizatim dhe grafikë.

**N3 – nota 7-8**

Nxënësi/ja është i nivelit MIRË kur demonstroi aftësitë për të zbatuar teknikat dhe elementet duke paraqitur variantin tonal të



	kompozicionit sipërfaqësor;  Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• kompozon në mënyrë korrekte dhe pa detaje grafike;</li> <li>• zbaton konceptet bazë në trajtimin teorik dhe i ushtron ato praktikisht në zbërthimin grafik me ndihmë;</li> <li>• shpjegon koncepte bazë të zbërthimit grafik në detyrën e vet;</li> <li>• shpjegon ndryshimin midis mënyrës së ndërtimit të kontrastit në vizatim dhe grafikë.</li> </ul>
<b>N 4 – nota 9-10</b>	Nxënësi/ja është i nivelit SHUMË TË MIRË kur demonstroi aftësitë për të krijuar variante të ndryshme koloristike të kompozicionit në detyrë Nxënësi/ja arrin këtë nivel, kur: <ul style="list-style-type: none"> <li>• kompozon duke sjellë individualitetin artistik një objekt ose një grup objektesh në letër;</li> <li>• organizon konceptet bazë në trajtimin teorik dhe i ushtron ato praktikisht në zbërthimin grafik;</li> <li>• interpreton koncepte bazë të zbërthimit grafik në detyrën e vet;</li> <li>• interpreton ndryshimin midis mënyrës së ndërtimit të kontrastit në vizatim dhe grafikë në detyrën e vet;</li> <li>• vlerëson nga ana teknike punën e tij dhe atë të të tjerëve.</li> </ul>
<b>Komente për detyrën e përfunduar</b>	

### Model ore mësimore në Specialitetin Piano, dega Muzikë.

<b>Dega:</b> Muzikë	<b>Lënda:</b> Piano	<b>Shkalla:</b> V	<b>Klasa:</b> X
<b>Repertori:</b> Repertor teknik & Repertor artistik			
<b>Repertori specifik</b> Shkalla Etyd Bach Sonata Nr 5, Bethoven			
<b>Kohëzgjatja:</b> Muaji Shtator – Tetor, 12 orë			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas sipas repertorit</b> <b>Nxënësi/ja:</b> - përzjedh programin teknik dhe artistik që do të luajë; - lexon saktë partiturat e pjesëve të përzgjedhura; - zgjidh probleme të ndryshme teknike gjatë studimit;		<b>Fjalë kyç</b> Teknikë Sonatë Shkallë Etyd	

<ul style="list-style-type: none"> <li>- lidh fragmentet e studiuara me njëra tjetrën.</li> <li>-</li> </ul>	
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Demonstrim nga mësuesi të pjesëve të përzgjedhura,</li> <li>- Pamje dhe diskutime rreth sonatës Nr 5 të ndryshme.</li> </ul> <p><a href="https://www.youtube.com/watch?v=jpkRaSf0o4U">https://www.youtube.com/watch?v=jpkRaSf0o4U</a>  <a href="https://www.youtube.com/watch?v=2tduPwBo9uk">https://www.youtube.com/watch?v=2tduPwBo9uk</a></p>	<p><b>Lidhja me fushat/lëndët e tjera</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Historia e Muzikës</li> <li>- Analiza e formës</li> </ul>
<p><b>Fazat e realizimit Muaji Shtator – Tetor</b></p> <p><b>Hapi I:</b>Mësuesi demonstroi veprat e pianistike <i>etyd, Bach dhe Sonatë nga Bethoven</i> për të krijuar idenë tek nxënësi për repertorin teknik dhe artistik.</p> <p><b>Hapi II:</b>Mësuesi dëgjon bashkë me nxënësitveprat e pianistike <i>etyd, Bach dhe Sonatë nga Bethoven</i> për të krijuar idenë tek nxënësi për repertorin teknik dhe artistik.  <a href="https://www.youtube.com/watch?v=jpkRaSf0o4U">https://www.youtube.com/watch?v=jpkRaSf0o4U</a>  <a href="https://www.youtube.com/watch?v=2tduPwBo9uk">https://www.youtube.com/watch?v=2tduPwBo9uk</a></p> <p><b>Hapi III:</b> Mësuesi lexon bashkë me nxënësitveprat e pianistike <i>etyd, Bach dhe Sonatë nga Bethoven</i> për të ezauruar problemet e partiturës, duke i përsëritur ato.</p> <p><b>Hapi IV:</b>Mësuesi zgjidh bashkë me nxënësitproblemet teknike gjatë lojës mbi veprat e pianistike <i>etyd, Bach dhe Sonatë nga Bethoven</i>.</p> <p><b>Hapi V:</b> Nxënësitushtrohen duke luajtur saktë veprat e pianistike <i>etyd, Bach dhe Sonatë nga Bethoven</i>.</p>	
<p><b>Vlerësimi teknik dhe artistik</b>  Vlerësimi i nxënësit kryhet sipas përmbushjes së niveleve të arritjeve për:</p> <p><b>Niveli 2</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studimin e programit/ repertorit teknik dhe artistik që do të luajë.</li> </ul> <p><b>Niveli 3</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizimin e teknikave pianistike në bazë të veprës që luan.</li> </ul> <p><b>Niveli 4</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzekutimin e veprave muzikore duke shfaqur individualitetin e vet artistik.</li> </ul>	
<p><b>Detyrat dhe puna e pavarur</b>  Studim individual për ekzekutimin e repertorit teknik dhe artistik.</p>	

### 3.2.2 Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur:



- mbështesin mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur për të gjykuar dhe vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore;

Zhvillimi i orës së hapur mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet, sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

### **Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur**

<b>Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur</b>				
<b>Gjithsej 70 pikë</b>				
<b>Përshkruesit</b>	<b>Niveli 1 - Dobët</b>	<b>Niveli 2 – Mjaftueshëm</b>	<b>Niveli 3 – Mirë</b>	<b>Niveli 4 – Shumë mirë</b>
<b>Planifikimi i orës mësimore të hapur (10 pikë)</b>				
<b>Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të nxënësve</b>	<b>0 – 1 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar orën mësimore pa pasur një koherencë të komponentëve. Rezultatet e të nxënësve (RN) nuk bazohen në programin lëndor dhe mësuesi nuk ka planifikuar situatë të nxënësve. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënësve. Pyetjet që u drejtohen nxënësve nuk janë sipas niveleve.	<b>2 – 3 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënësve, e cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e rezultateve të të nxënësve (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxënësve. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxënësve, Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.	<b>4 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënësve, si dhe ka planifikuar organizimin e nxënësve. Metodot dhe teknikat mësimore janë në një koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënësve dhe me stilet e të nxënësve. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.	<b>5 pikë</b> Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësve sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënësve të cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënësve, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.
<b>Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që</b>	<b>0 – 1 pikë</b> Mësuesi ka një planifikim ditor rutinë, pa u kujdesur për qasje	<b>2 – 3 pikë</b> Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale.	<b>4 pikë</b> Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen	<b>5 pikë</b> Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të

<p><b>lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënësve gjatë jetës, krahas kompetencave lëndore</b></p>	<p><i>të reja inovative dhe pa përfshirë edhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i></p>	<p><i>Metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i></p>	<p><i>me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i></p>	<p><i>reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënësve gjatë gjithë jetës.</i></p>
---	--	--	--	---

#### Mjedisi i të nxënësve (14 pikë)

<p><b>Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.</b></p>	<p><i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, ku jo të gjithë nxënësit kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimi vetëm disa nxënës ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i></p>	<p><i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i></p>	<p><i>4 - 5 pikë</i> <i>Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i></p>	<p><i>6 - 7 pikë</i> <i>Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i></p>
<p><b>Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndër marrin iniciativë, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</b></p>	<p><i>0 – 1 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimi në mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm disa nxënës nxitin të marrin pjesë në mësim, të tjerët nuk nxitin me detyra motivuese.</i></p>	<p><i>2 – 3 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimi në mënyrë tradicionale, ku jo të gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës nxitin të marrin pjesë në mësim dhe të ndër marrin</i></p>	<p><i>4 - 5 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimi duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese duke i lënë disi pasiv.. Ai i kushton vëmendje kur ata</i></p>	<p><i>6 - 7 pikë</i> <i>Mësuesi organizon orën e mësimi duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të ndër marrin iniciativë. Ai i kushton vëmendje</i></p>

	<i>Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimit.</i>	<i>iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>
<b>Metodat mësimore (21 pikë)</b>				
<b>Mësuesi organizon nxënësit në varësi të metodave që do të përdorë dhe stileve të nxënimit</b>	<i>0 – 1 pikë Mësuesi nuk organizon nxënësit në varësi të metodës së zgjedhur dhe demonstroi që nuk i njeh stilet e të nxënimit. Ora e mësimit është rutinë dhe kryesisht tradicionale.</i>	<i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi që i njeh stilet e të nxënimit të nxënësve të tij por ora e mësimit është tradicionale pa u kujdesur që nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre bazuar në stilin e tyre të të nxënimit.</i>	<i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi që i njeh stilet e të nxënimit të nxënësve të tij por metodat e teknikat që përdor në orën e mësimit nuk përfshijnë të gjitha stilet e të nxënimit duke krijuar kushte që jo të gjithë nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre.</i>	<i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi që njeh shumë mirë stilet e të nxënimit të nxënësve të tij dhe përdor metoda e teknika që i lidh më së miri me stilet e të nxënimit duke i dhënë mundësi nxënësit të përmirësojnë arritjet e tij.</i>
<b>Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin).</b>	<i>0 – 1 pikë Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimit duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore mësimit fokusohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i>	<i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimit duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i>	<i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxit mendimin kritik, krijues të nxënësit, por vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i>	<i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshërinë e metodave të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik, krijues të nxënësit, që nxisin diskutimin (apo debatin) dhe i jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i>
<b>Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të</b>	<i>0 – 1 pikë Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e</i>	<i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për</i>	<i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve.</i>	<i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve.</i>

<b>bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.</b>	<i>pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe niveleve të ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje..</i>	<i>nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit dhe njëri – tjetrit.</i>
--	--	---	--	--

**Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (17 pikë)**

<b>Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij.</b>	<i>0 – 1 pikë Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimit.</i>	<i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi përdor vlerësimin nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit.</i>	<i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij.</i>	<i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit.</i>
<b>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes.</b>	<i>0 – 1 pikë Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi por nuk përdor nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	<i>2 – 3 pikë Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	<i>4 pikë Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>	<i>5 pikë Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.</i>
<b>Mësuesi angazhon nxënësit me</b>	<i>0 – 1 pikë Mësuesi jep detyra për të gjithë</i>	<i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi se një</i>	<i>4 pikë Mësuesi demonstroi se një</i>	<i>5 pikë Mësuesi demonstroi se një nevojat e</i>

<b>detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësve dhe nevojave të nxënësve</b>	<i>nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënësve apo nevojat e nxënësve.</i>	<i>nevojat e nxënësve, angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	<i>nevojat e nxënësve, angazhon nxënësit me detyra të diferencuara bazuar në nevojat e tyre.</i>	<i>nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësve dhe nevojave të tyre.</i>
<b>Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (8 pikë)</b>				
<b>Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i>	2 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i>	3 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore, por nuk angazhon shumë nxënës në përdorimin e tyre.</i>	4 pikë <i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në përbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxënësit të mësuarin praktik dhe krijues.</i>
<b>Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve</b>	0 – 1 pikë <i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore,</i>	2 pikë <i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale por përbajtja nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënësve të temës mësimore.</i>	3 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore, por nxënësit nuk angazhohen në përdorimin e TIK.</i>	4 pikë <i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>

